



VENDIM

Nr. 152, Datë 11.12.2015

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR VENDOSJEN E GJOBAVE
DHE KUSHTET E LEHTËSIMIT PREJ TYRE**

Në mbështetje të neneve 106/2 dhe 107 të Ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe nenit 25 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE", Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe relacionin përkatës,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e Draft - Rregullores për vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtësimit prej tyre".
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve të interesuara për Vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI